



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e **Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF)**, e mbajtur më **17.03.2025**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! I nderuar nënkryetar i komunës, **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të OSBE-së, të gjithë ju të pranishëm. E hapim mbledhjen e **tretë (3)** të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2025. Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë rend dite;

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin e Muzeut Etnografik në Drenoc;
3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2023 dhe 2024 në vitin 2025;
4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik, P- 00320-0, ZK-Radoste;
5. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzimafatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, P-00320-0, ZK-Radoste;
6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës personave fizik dhe juridik, P- 02240-81, ZK-Rahovec;
7. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzimafatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës P-02240-81-0, ZK-Rahovec;
8. Shqyrtimi i informatës mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre;
9. Shqyrtimi i informatës rreth menaxhimit të aseteve komunale;
10. Të ndryshme.

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë të KPF-së, tani rendin e ditës e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht (5) votohet rendi i ditës për sot.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: Nëse dikush ka ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash (5), votohet pika e parë e rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin e Muzeut Etnografik në Drenoc:

Afrim Dina: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, kolegë drejtorë, të nderuar anëtarë të KPF-së, përfaqësues të LMT-së. Para vetes e keni vendimin e kryetarit të komunës për themelimin e Muzeut Etnografik në Drenoc. Më datë 19.09.2024, kryetari i komunës ka formuar grupin punues, i cili është marrë me artefaktet që gjenden në muzeun e Drenocit. Objekti është në shkollën e vjetër të Drenocit. Objekti është pronë e komunës dhe aty janë 850 artefakte, si dhe 330 fotografi që janë mbledhur nga mësuesi Nazmi Berisha, nga nxënësit dhe banorët e fshatit. Qëllimi i themelimit të muzeut është që këto artefakte të jenë nën përkujdesjen institucionale dhe objekti brenda ka

nevojë për disa ndërhyrje rreth mirëmbajtjes. Të nderuar anëtarë të KPF-së, pas shqyrtimit ju ftoj që ta votoni këtë pikë.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A kemi ndonjë diskutim? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Konstatohet që unanimisht (6) votohet pika e dytë e rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2023 dhe 2024 në vitin 2025;

Afrim Limani: I nderuar kryesues, nënkryetar, anëtarë të KPF-së. Para vetes i keni dy dokumente, propozim për bartjen e mjeteve nga viti 2023 dhe 2024 në vitin 2025. Shuma për bartje është 679.543€. Në dokumentin e dytë që është i paraqitur në formë tabelare, janë projektet e propozuara. Shumica janë projekte të reja dhe kanë dalur si rezultat i propozimit të drejtorëve, në kuadër të planit të prokurimit. Si propozime janë: Rregullimi i tribunës në kompleksin sportiv, vendosja e gomës në shtegun e atletikës – faza e tretë, 50.000€. Rregullimi i hapësirave të ish-objekteve të AKP-së, 65.743€, rregullimi i çatisë së amfiteatrit në Dejnë, 30.000€, ndërtimi i qendrës përkujtimore në Retijë, 50.000€. Rregullimi i rrethojave të oborreve të shkollave, 55.000€, ndërtimi i rrugëve lokale, 60.000€, rregullimi i çatisë së palestrës “Mizahir Isma”, 50.000€. Restaurimi i muzcut dhe objekteve përkujtimore, 55.000€, rregullimi i oborrit dhe riparimi i mbrendshëm i objektit të zjarrfikësve, 30.000€, renovimi dhe përmirësimi i infrastrukturës rrugore në vendbanimet e komuniteteve joshumicë, 30.000€ dhe ndërtimi dhe renovimi i QMF-ve dhe AMF-ve në vlerë prej 38.000€ është pjesa e një kontrate që ka ngelur. Gjithashtu, kemi ndarë mjete 50.000€ kryesisht për kadastrë, si dhe subvencione në Drejtorinë e Bujqësisë, 50.000€.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Diskutimi është i hapur nëse keni ndonjë gjë? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Konstatohet që unanimisht (6) votohet pika e tretë e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit paraparak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik, P- 00320-0, ZK-Radoste:

Afrim Oruqi: Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar dhe anëtarë të KPF-së. Me propozim të kryetarit, ju propozoj që të marrim vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për 15 vjet, P- 00320-0, ZK-Radoste, në sipërfaqe prej 7 ari e 70m². Qëllimi i dhënies në shfrytëzim është ruajtja dhe rritja e vlerës, si dhe vetëpunësimi i qytetarëve.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A kemi ndonjë diskutim? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Konstatohet që me 3 vota “për”, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, votohet pika e katërt e rendit të ditës. Me lejen tuaj, e lus drejtorin që t’i prezentojë pika me radhë, të pestën, të gjashtën dhe të shtatën.

5. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzimafatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, P-00320-0, ZK-Radoste:

Afrim Oruqi: Vendim për formimin e komisionit, i cili do të merret me të gjitha procedurat e nevojshme që pronën ta japim në shfrytëzim për 15 vjet, P- 00320-0, ZK-Radoste. Komisioni ka 5 anëtarë, 2 prej tyre nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi dhe 1 nga sektori joqeveritar.

6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit paraparak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës personave fizik dhe juridik, P- 02240-81, ZK-Rahovec:

Afrim Oruqi: I propozojmë kuvendit që të marrim vendim, që ta japim në shfrytëzim pronën komunale për 50 vjet, në sipërfaqe të përgjithshme 2 ha e 80 ari. Prona gjendet në rrugën Rahovec-Malishevë, në anën e djathtë. Qëllimi: zhvillimi i biznesit dhe punësimi. Sipas PZhK-së, parcela në fjalë është zonë ndërtimore. Çmimi do të përcaktohet në bazë të rregullores në pikën 1 dhe 2.

7. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzimafatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës P-02240-81-0, ZK-Rahovec:

Afrim Oruqi: Vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për këtë parcelë, në zonë të njëjtë dhe sipërfaqe të njëjtë. Komisioni ka 5 anëtarë, 2 prej tyre nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi dhe 1 nga sektori joqeveritar.

Kryesuesi: Faleminerit drejtor! E vendosim në votim pikën e **pestë**, nëse dikush nuk ka ndonjë diskutim! Kush është është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht (6), votohet pika e pestë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e **gjashtë**. Kush është është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht (6), votohet pika e gjashtë e rendit të ditës. E vendosim në votim pikën e **shtatë**. Nëse nuk kemi diskutim, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht (6), votohet pika e shtatë e rendit të ditës.

8. Shqyrtimi i informatës mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre:

Afrim Oruqi: Bazuar në planin e kuvendit, një herë në vit ju raportojmë për pronat komunale dhe menaxhimin e tyre. Fatmirësisht në 34 zona kadastrale ka prona të komunës. Këtu i keni të listuara pronat në secilën zonë kadastrale. Në vendimet e shpronësimit ka rritje të pronës komunale.

9. Shqyrtimi i informatës rreth menaxhimit të aseteve komunale:

Erhan Morina: Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë drejtorë, anëtarë të KPF-së, media. Para jush e keni dokumentin mbi menaxhimin e aseteve komunale për vitin 2024. Në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm gjendet edhe sektori për menaxhimin e aseteve komunale. Gjatë vitin 2024 në këtë sektor janë kryer një mori aktivitete. Është bërë regjistrimi i aseteve të reja komunale, inventarizimi i pasurive jofinanciare, janë zhvilluar dy ankande publike për shitjen e aseteve të papërdorshme të komunës dhe punë të tjera të parapara. Në fillim të vitit 2024, me vendim të kryetari të komunës janë formuar 4 komisione: Komisioni për regjistrimin e pasurive jofinanciare, komisioni për inventarizimin e pasurive jofinanciare, komisioni për tjetërsimin e pasurive jofinanciare dhe komisioni për asgjësimin e pasurive jofinanciare. Komisioni për regjistrimin e pasurive jofinanciare ka bërë regjistrimin e aseteve publike në objektet e administratës komunale, objektet kulturore-sportive, në shkolla, QKMF dhe AMF. Në administratë komunale, në objektet kulturore dhe sportive janë evidentuar gjithsej 7394 asete. Në shkolla 21.479 asete dhe në QKMF-AMF janë regjistruar 2792 asete. Komisioni për inventarizimin e pasurive jofinanciare, në arsim janë inventarizuar 21.478 asete, ku 645 prej tyre janë jashtë përdorimit. Në QKMF-AMF, janë inventarizuar 2792 asete dhe prej tyre 28 janë jashtë përdorimit. Në administratë janë inventarizuar 7394 asete dhe 120 prej tyre janë jashtë përdorimit. Në raportin përfundimtar të komisioneve për inventarizim të të gjitha objekteve komunale janë evidentuar gjithsej 793 asete që janë jashtë përdorimit. Shumica prej këtyre aseteve u janë nënshtruar dy ankandeve publike. Regjistrimet mbi 1000€ dhe më pak se 1000€ gjatë vitit 2024 kanë qenë 261 regjistrime, në vlerë prej 14.708.428. Regjistrimet më pak se 1000€ kanë qenë 1272 regjistrime, në vlerë 103.152€.

10. Të ndryshme:

Nënkryetari: Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të KPF-së, ju falënderoj për kontributin e jashtëzakonshëm në këtë rend dite (kjo ishte për relaks). Sidoqoftë, ju njoftoj që në seancën e rregullt e kuvendit komunal do të jenë edhe këto pika shtesë: Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të parcelës, P-71510057-00095-6 në ZK-Rahovec; Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV); Informatë rreth “Park Hotel - Plaza”; Raport rreth fatkeqësive natyrore për 2024 nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Kryesuesi: Faleminerit nënkryetar! Nëse nuk keni ndonjë gjë tjetër? Nëse jo, ju falënderoj për vëmendje dhe shihemi në mbledhjen e rregullt të kuvendit.

Procesmbajtësi

Albion Krasniqi

KRYESUESI

Arbër Zenuni



